

# Akt Themelimi

## I Shoqerise Tregtare "ESTER & BRILLANT" SH.P.K

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512

date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit" , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , " Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 "Per Q.K.B dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin e tij te lire , te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi ne ortaket : individ me pergjegjesi te kufizuar, banues ne Elbasan , te krijojne shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "ESTER & BRILLANT" SH.P.K me akt themelimi si vijon :

### Formulimi

#### Neni 1

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur "ESTER & BRILLANT" SH.P.K. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqipetar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega . Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues .

### Selia e Shoqerise

#### Neni 2

Selia e shoqerise tregtare private " ESTER & BRILLANT " SH.P.K do te jete ne ELBASAN, Lagjja Sul Papri, rruga e Re e trenit, Zona Kadestrale 8522 Nr. Pasurie 1/288+1-1, kati 1;. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te krijojte filiale si Brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise , vetem me vendim te asamblese dhe ortakeve.

### Objektivi i Veprimtarise

#### Neni 3

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e :

- 1- Import-eksport
- 2- Tregti me pakicë tekstile
- 3- Perpunim tekstile
- 4- Aksesore
- 5-Metrazhe
- 6- Qepje perdesh dhe montim perdesh, Rolerash, etj

### Kohezgjatja e Shoqerise

#### Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar. Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku .

## Kapitali i Shoqerise

### Neni 5

Kapitali fillestar I shoqerise private "ESTER & BRILLANT" SH.P.K do te jete 500.000 (pese qind mije leke). Kapitali eshte 100% nga kuotat e ortakeve, 50% seicili, e ndare ne 2 kuota.

Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet ( por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar ).

## Drejtimi I Shoqerise

### Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga Administratoria e saj. **Zj Brunilda Fingo**. Ajo eshte perfaqesuesia e Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj .

Cdo kontrate do te kryhet prej saj dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posacme .

### Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise I takojne ortakeve .

### Neni 8

Ortaket themelues kane te drejte te emeraje dhe administratore te tjere te vlerave materiale  
Ka te drejte te caktoje financiere , likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake .

### Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Elbasan.

### Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme , me tekstin rreth saj.

### Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare" , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri .

### Neni 12

Akti I themelimit u perpilua ne 2 kopje , per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "ESTER & BRILLANT" SH.P.K


Akti I themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortakët .

## Ortakët themelues të " ESTER & BRILLANT " SH.P.K

Afrim Cërriku



Odise Cërriku



Dt: 21.07.2021.